

DEKLARATË

Për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe profesional të banorëve të zonave rurale dhe malore

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe rreth 40 organizatat e saj anëtare shprehin shqetësimin e tyre të thellë në lidhje me situatën alarmante me të cilën po përballen komunitetet rurale dhe malore të zonës së Thethit.

Mes varfërisë dhe përjashtimit social, historikisht të harruar nga mbështetja e insitucioneve publike, brez pas brezi, banorët e Thethit kanë vendosur të qëndrojnë dhe investojnë në komunitetet e tyre.¹ Përgjatë vitit të fundit sinjalet e dhëna nga institucionet publike dhe miratimi i Paketës së Maleve kanë ngjallur interesin e banorëve dhe emigrantëve të kthyer për të investuar në fshatrat e tyre, por pa i orientuar qartësisht se si dhe ku duhet të investojnë.

Duke filluar nga data 8 korrik 2025, ndërhyrja e papritur dhe e dhunshme e insitucioneve publike për të shkatërruar investimet e bëra në fshatin e Thethit, pikërisht në kulmin e sezonit turistik, dëshmon për mungesë serioze të transparencës dhe llogardhënies institucionale në nivel vendor dhe qendror. Kjo situatë ka krijuar tensione dhe pasiguri për banorët dhe turistët, si dhe dëme të shumta ekonomike e morale, duke rrezikuar kështu burimet e jetesës, nxitjen e emigrimit të popullsisë dhe thellimin e varfërisë dhe përjashtimit social.

Në reagim të kësaj suate, ANRD kërkon me këmbëngulje vëmendje aktive dhe reagim urgjent nga ana e insitucioneve përgjegjëse në lidhje për sa më poshtë:

- Ndërprerjen e menjëhershme të çdo akti që rrezikon mirëqenien dhe sigurinë e banorëve të Thethit dhe mundësimin e një afati të arsyeshëm për zhvendosjen e investimeve, si shtëpitë prej druri dhe strukturat të tjera lëvizshme.
- Thirrjen e një dialogu të hapur me pjesëmarrjen e insitucioneve publike dhe banorëve të zonës së Thethit për të diskutuar dhe gjetur një zgjidhje konsensuale dhe të drejtë.
- Hetim dhe transparencë institucionale mbi procesin e vendimmarrjes dhe mungesën e marrjes së masave parandaluese ndaj ndërtimeve pa leje, duke kërkuar nga institucionet vendore mbajtjen e përgjegjësisë për moszbatimin e legjislacionit në fuqi.
- Hartimi i një skeme dëmshpërblimi për dëmet ekonomike dhe morale të shkaktuara nga ndërhyrja e papritur e insitucioneve publike në Theth.
- Rivlerësimi i Paketës së Maleve duke përfshirë mekanizma konkretë që do të mundësojnë, ekskluzivisht, banorët e Thethit të përfitojnë dhe kompensojnë dëmet ekonomike e morale të shkaktuara nga ndërhyrja e paparalajmëruar për shkatërrimin e investimeve.

Situata aktuale është një këmbanë alarmi jo vetëm për banorët e Thethit, por për të gjitha zonat rurale dhe malore të vendit. Pasojat afatgjata kërcënojnë zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre komuniteteve, duke rrezikuar sidomos emigrimin nga zonat rurale dhe humbjen e dëshirës së të rinjve për të investuar në këto zona.

ANRD dhe organizatat e veta anëtare mbeten të angazhuar dhe përkushtuar për të monitoruar në vazhdimësi situatën dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në ndërmarrjen e veprimeve

¹ Deklarata e Parlamentit të Tretë Shqiptar 2023. Në https://anrd.al/wp-content/uploads/2024/06/Alb_Parlamenti-Rural-Shqiptar-3-Deklarata_Final-2-002.pdf

konkrete për të rikthyer dinjitetin njerëzor dhe profesional të banorëve të zonave rurale dhe malore.

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
Agjencia e Zhvillimit Rajonal Lezhë
AGRIEN Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore (AGRIEN)
Agrinas Ersekë
Shoqata GVV “Kolonja e Gjelbër”
AgriNet Albania
AGROPUKA
Bashkëpunimi për Zhvillimin e Vendeve në Emergjencë (COSPE)
Creative Bussiness Solutions (CBS)
Diakonia Agapes
Dorcas Aid International Albania (DAI Albania)
Federata Bujqesore Elbasan
Fondacioni CESVI Onlus (CESVI)
Grate ne Bujqesine e Qendrueshme (WSA)
Help Shqiperi
Instituti i Bujqësisë Biologjike (IBB)
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
Instituti për Paqe, Zhvillim dhe Inovacion (ACLI-IPSIA)
Klubi i Sipërmarrësve të Rinj (KSR)
Koordinimi i Organizatave për Shërbim Vullnetar (COSV)
Programi për Mbështetjen e Shoqatave Rurale (RASP)
Qendra Agritra-Vizion
Qendra e Rinisë Rurale (RYH)
Qendra Konsumatori Shqiptar
Qendra për Zhvillim dhe Integrim (CDI)
Shoqata "Integrimi" Tropojë
Shoqata “Aleanca Alpeve Shqiptare”
Shoqata e Përdoruesve të Burimeve Natyrore Velçan
Shoqata GVV “Mokër-Gorë”
Shoqata e Zhvillimit Bujqesor të Rrethëve Malore (ADAD Malore)
Shoqata Ishmi
Shoqata mjedisore “Çajupi”
Shoqata për Integrimin Gjinor (FGIA)
Shoqata GVV “Pro Përmet”
Vizion i Gjelbër
Volontari nel Mondo (RTM)
Vullnetarizmi Ndërkombëtar për Zhvillimin (VIS Albania)
World Vision Albania